



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T I

Nga procesverbali i mbledhjes së 27-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 29.02.2024, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Gazmend Qerkini, anëtar
5. Shkelzim Olluri, anëtar
6. Albiona Tasholli, anëtare
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Sami Bytyqi, anëtar
9. Fitim Shala, anëtar
10. Xhyzide Rustemi, anëtare
11. Rinor Murati, anëtar
12. Armend Grajqevci, anëtar
13. Gentianë Hoxhaj, anëtare
14. Venhar Agushi, anëtar
15. Xhyla Dedushaj, anëtare
16. Lulzim Rustemi, anëtar
17. Herolind Kozhani, anëtar
18. Ardit Cani, anëtar
19. Arsim Jashari, anëtar
20. Egzona Bytyqi, anëtare
21. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
22. Ganimete Qeriqi, anëtare
23. Alban Salihu, anëtar
24. Fitim Meziu, anëtar
25. Fatmir Fetahu, anëtar
26. Shahadije Dragaçina, anëtare
27. Besiana Sylja, anëtare
28. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i komunës
2. Diamant Bytyqi, nënkryetar i komunës
3. Lulzim Rrustemi, nënkryetar i komunës
4. Latif Ramadani DBF
5. Valon Pacolli, DEZH
6. Shkelzen Hajdini, DSH
7. Elmaze Behluli, DA
8. Sead Aliu, DI
9. Rexhep Rexhepi, DBP
10. Rasim Hasani, DA
11. Safete Amerrlahu, DGJK
12. Burim Rrustemi, DSHPM SH
13. Imri Semetishti, DUPMM
14. Anila Reqica-LLugiqi
15. Flamur Sylejmani, DI
16. Shemsi Azemi, Koordinator i përformacës
17. Petrit Reqica, kompania Pastrimi
18. Skender Bikliqi, Kryesues i komitetit për Komunitete
19. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit, tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë me kohë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 26-të e Kuvendit.
2. Propozim vendim për miratimin e raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në komunën e Lipjanit për vitin 2023
3. Raporti Financiar i KRM "PASTRIMI" SH.A për Njësinë Operative të Lipjanit për vitin 2023
4. Raporti i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023
5. Raporti i përformancës së komunës së Lipjanit për vitin 2022
6. Raporti, Janar-Dhjetor 2023, i punës së zyrës së Kryetarit dhe drejtorateve komunale

Pastaj Kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, tha se me kërkesën e ekzekutivit dhe me rekomandim të KPF-së do ta keni edhe një pikë shtesë për të cilën e keni marr materialin me kohë.

7. Propozim Vendim për miratimin e planit për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Lipjanit 2024-2028

Pastaj Kryesuesi e hodhi në votim se pari që të hyjë në rend të ditës si pikë shtesë Propozim Vendim për miratimin e planit për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Lipjanit 2024-2028

Pas votimit u konstatua se kuvendi me 21 vota për dhe 3 abstenime e aprovoi këtë propozim.

Pastaj Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit u konstatua se me 25 vota për u aprovua rendi i ditës.

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtarëve të kuvendit?

Enver Kryeziu, tha se e kam një pyetje për Komisionin për Regjistrimin e Popullsisë, pse nuk është pranuar asnjë regjistrues nga Komuniteti Ashkali.

Herolind Kozhani, tha i kam disa pyetje, e para sa i përket ujësjellësit Ribar i Madh, Kraishtë, Zllakuqan, pse nuk po zhvillohet ky projekt a keni ndonjë informatë zyrtare se ku ka ngec puna?. Pyetja e dytë, rruga "Mbreti Zog" në Lipjan është dëmtuar a ka mirëmbajtje ose a keni bërë kërkesë për sanimin e dëmeve pasi që është dëmtuar ajo rrugë. Te web faja e komunës, mungojnë shumë informacione, kam shikuar vendimet e kryetarit por nuk i kam gjet. Tjetra të punimet që po zhvillohen të nënkalimi janë larguar kabllot e instalimit dhe shtyllat e ndriçimit, ku kanë mbet ato? a ka informatë drejtorja përkatëse.

Alban Salihu, tha se kam disa pyetje, e para për drejtorinë e shëndetësisë, a do të ketë orar të shkurtuar në QKMF. Pyetje për kryetarin e komunës pse nuk marr pjesë në një takim të organizuar nga Kryeministri i Kosovës? Çështje tjetër, bizneset të nënkalimi po përballen me vështirësi pasi që aty po zhvillohen punimet, a e ka menduar komuna që të ju ndihmojë këtyre bizneseve.

Besiana Sylja, tha se unë kam për ti ngritur disa çështje, e para, komunës së Lipjanit Ministria PMM i ka bërë thirrje për caktimin e lokacionit për banim të përballeshëm afati për paraqitjen e dokumentacionit është deri me datën 29 mars, a i ka plotësuar këto dokumentacione komuna a është marr me këtë çështje. E dyta ka

të bëjë me psikologët në mbi 50 institucione shkollore në komunën e Lipjanit janë të angazhuar vetëm 5 psikologë, a është menduar që të ketë më shumë psikolog nga DKA, Çështja tjetër ka të bëjë me qentë endacak, në Kuvend kemi nda mjete për këtë çështje a është bërë ndonjë zgjidhje.

Shahadije Dragaçina, tha se kam për ti ngritur disa çështje e para ka të bëjë për rrugën për Bukovicë Janjevë, ku për këtë rrugë kanë bërë edhe petition dhe është shume jetike për këta banorë. E dyta mungesa e një pediatri në QKMF në Lipjan është shqetësuese. E treta, rruga nga ambulanca deri te Shtëpia e Kulturës, aty po rrezikohen qytetarët nga vozitja e shpejtë e veturave është mirë që komuna të bëjë një zgjidhje.

Bashkim Budakova, tha se kam një pyetje për ekzekutivin, rruga Lipjan Rubovc është shëndërruar në deponi ilegale të mbeturinave, a është ndërmarr veprim ndëshkues apo vedijues për parandalimin kësaj dukurie.

Fadil Spahiu, tha se çështja e parë ka të bëjë me DKRS-në, lidhur me subvencionet në sport e që ka të bëjë me KF Gadimja që është në ligën e tretë, mirëpo subvencioni për këtë ligë është shumë i ulët pasi që ka kosto të shpenzimeve të mëdha. E dyta ka të bëjë me Rregulloren për Orarin e Veprimtarive Ekonomike që dita e dielë të jetë ditë pushimi e cila po kërkohet edhe nga bizneset dhe qytetarët, e cila është e pezulluar, kur pritet të fillojë të zbatohet kjo rregullore. E treta ka të bëjë me banorët e fshatit Smallushë konkretisht të lagjes Spahiu, për asfaltimin e rrugicave të tyre, e të cilat lidhen me rrugën publike.

Egzona Bytyqi, tha se kam disa kërkesa e para ka të bëjë me drejtorinë e shëndetësisë, ku i kam marr disa ankesa nga infermierët, kategoria bachelor ata të cilët e kanë përfunduar masterin, në muajin Janar ndërsa ligji i pagave ka hyrë në fuqi në muajin shkurt, e këta vazhdojnë ta marrin pagën me koeficient 5.1 që është dashtë deri tani të bëhet harmonizimi i koeficientit të tyre. A ju janë drejtuar instancës më të lartë drejtoria në fjalë për këtë çështje. Tjetra ka të bëjë për infermieret në Magure të cilët po detyrohen të punojnë vikendeve për plotësim të orëve të punës dhe kjo po ju bëhet e pa drejtë. Se di sa keni informacion si drejtori që do të jetë një projekt për trajtim të mjekëve për trajtimin e ultrazërit që do të ishte mirë që edhe ne të bëjmë një kërkesë për këtë çështje. Dhe çështja e fundit fenomeni i rrahjes së disa nxënësve në shkollat fillore është shqetësuese dhe duhet dhe si KKSB me trajtuar këtë çështje dhe të bëjmë një zgjidhje.

Ganimete Qeriqi, tha se unë kam për ti ngritur disa çështje të banorëve të fshatit tim, për disa punë që janë përfunduar më herët por nuk janë punuar mirë. Po

ashtu edhe ujësjellësi është punuar por nuk ka funksionuar asnjëherë edhe pse nuk është faji te ju por është mirë të sanohen këto gabime. Për drejtorinë për Ekonomi dhe Zhvillim kam pyetje, keni thënë në raport që do të renovohen disa shtëpi së bashku me UNDP-në, në Janjevë, a mundemi me ditë më saktë për çka bëhet fjalë.

Ardit Cani, tha se do ta ngris një shqetësim të banorëve të fshatit Shalë rreth kamionëve që po vozisin në fshatin Shalë me pesha të rënda dhe nuk kanë mbulojë për gurët që i bartin, kërkoj nga drejtoria e inspekcionit të merret me këtë çështje. Tjetra ka të bëjë me shkollë "Haredin Bjarami" në Magure, paralela e ndarë në Qylagë e cila është në gjendje shumë të keqe. Kërkesën tjetër e kam për drejtorinë e infrastrukturës për asfaltimin e rrugicave në fshatrat Balcë Shalë dhe Resinoc. Po ashtu të jetë prioritet asfaltimi i rrugicave aty ku ka raste invalidore, si dhe asfaltimin e parkingut të burimi i ujit të nxehtë.

Arsim Jashari, tha se kam një propozim dhe disa kërkesa, e para me që po ndërtohet qendra e kulturës në Lipjan e kam një propozim që të vendoset një memorial me foton dhe historikun e tij një biografi e shkurtër për historikun e tij. Do të isha i nderuar të merrej parasysh. E dyta është rrahja e nxënësve në shkolla që është shqetësim i të gjithëve dhe kërkoj nga prindërit nga KKSB-ja, dhe të gjitha institucionet tjera të marrin masa të mos vij te ma e keqja. Kam 3 kërkesa nga fshati Grackë për vazhdimin e trotuarit nga fshati deri në rrugën kryesore, e dyta mbjellja e drunjtëve dekorativ në pronën publike. Si dhe vendosja e pengesave në rrugë, që është kërkesë edhe e disa fshatrave të tjera, pasi që po rrezikohen qytetarët dhe nxënësit gjatë vozitjes me shpejtësi të madhe të veturave. Tjetra çka po ndodh me stadiumin e Dobrajës dhe të Magurës. Pse janë ndryshuar kriteret nga DKRS-ja, për subvencionimin e klubeve sportive.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se po flitet që do të ndryshohet orari i institucioneve shëndetësore në Lipjan dhe do të jetë një orar i ri e kjo po i shqetëson qytetarët e sidomos ata të Shalës e të cilët kanë nevojë që orari të bëhet 24 orë e jo të shkurtohet ende. QMF është mirë që të përjashtohen nga ky orar. Çështja tjetër është vozitja e kamionëve me pesha të rënda në fshatin Shalë që po i shqetëson banorët e asaj pjese. Çështja tjetër është moszbatimi i vendimeve të kryetarit të komunës edhe pse janë marr disa vendime, për shembull vendimi për ndalimin e mjeteve piroteknike në Lipjan, njëjtë vendimi për ndalimin e motoçikletave dhe trotineteve në shesh. Në shpalljen e listës për kontrollorë të publikuar nga ASK, nuk ka përfaqësues nga komunitetet e për këtë duhet të reagoj komuna dhe të jep një sqarim nëse komuna ka qenë pjesë e përzgjedhjes ose jo. Te nënkalimi që po bëhet është një pjesë e hapur dhe

duhet të ketë vendosje të disa mburojave. Shtyllat elektrike në rrugën “Isa Olluri” është shqetësuese, dhe ato shtylla duhet të largohen.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës pasi i përshëndeti të pranishmit tha se e para nuk është mirë me bërë temë për diçka që nuk ekziston, orari në institucionet shëndetësore nuk do të ndryshoj, përkundrazi ne jemi që në disa qendra të rritet orari. Mjetet piroteknika ka pas një vendim, dhe ato janë shit vetme në tregun e gjelbër dhe ka pas edhe gjoba. Çështja e regjistruarëve dhe mbikëqyrësve është në përgjegjësinë e ASK-së, dhe nuk është që ka pas interesim të madh nga qytetarët, po ju them që njoftoni studentët e të rinjtë që njihni të aplikojnë. Ne kemi formuar komisionin të udhëhequr nga nënkryetari i komunës dhe anëtarë të tjerë. Te dy stadiumet në Dobarije dhe Magure do të publikohen shumë shpejtë dhe do të ndërtohen. Subvencionimi i klubeve sportive ka rritje vitë pas viti dhe si komunë jemi mirë edhe këtë vit do ti mbështesim klubet sportive, por j’u duhet klubeve edhe mbështetja e donatorëve. Memorialin për Tahir Sinanin do ta diskutojmë me kohë dhe propozim i mirë. Fenomeni i rrahjes se te rinjve në shkolla fenomen që ka ndodh edhe në të kaluarën, por duhet që të merremi të gjithë me këto tema në mënyrë që të kemi më pak raste të tilla. Pengesat e vendosura në disa rrugë janë të nevojshme. Vozitja e kamionëve është përgjegjësi e vet shoferëve por edhe e policisë. Sa i përket shkollave ne kemi pas një kontratë për mirëmbajtje por ju ka shkëputur kontrata për shkak të papërgjegjësisë së operatorit, si po kemi telashe edhe me kontrata tjera ku operatorët po janë të pa përgjegjshëm. Do të filloj shumë shpejtë kontratë e re për renovimin e disa shkollave. Në Janjevë janë duke u rinovuar 14 shtëpi së bashku me Ministrinë e Kulturës dhe UNDP –në. Orari i punës për biznese, nëse në Lipjan e ndalojmë atëherë qytetarët do të shkojnë në pjesën që i takon Garaçanicë dhe kjo nuk po na konvenon dhe është njëra nga pengesat. Ujësijellësi në regjionin e Kreishtës, ka qenë një projekt nga CDI Zvicëranë, mirëpo i ka ndërprerë punimet atje, ne kemi kërkuar që të na bije projektin çka ka mbet pa u kryer na e vazhdojmë por jemi në fazën pritjes ende. Ne web faqen e komunës janë të publikuara të gjitha vendimet dhe ne si Lipjan për këtë punë prijmë. Rruga Mbreti Zog, nëse ka hapësirë do të zgjerohet dhe të ri konstruktohet. Banimi i përballueshëm, ne kemi aplikuar si komune dhe pronën e kemi ofruar në Mgure të objektet e vjetra në Magure ne kemi aplikuar me kohe po presim. Psikologët e drejtë por ne nuk kemi drejt ta rrisim numrin e punëtorëve në arsim. Qenet endacakë problem në vete dhe ne kemi ndare disa mjete si komune për këtë çështje. Në Bukovicë jeton vetëm një familje dhe nuk kemi mundësi që ta asfaltojmë por do ta zhavorojmë. Pediatër ka pas vazhdimisht konkurs po nuk ka pas interesim. Rruga Lipjan Rubovc, ne i kemi largu aty mbeturinat janë gjuajtur prapë dhe janë shqiptuar edhe gjoba, por do të shohim çka mund të bëjmë pasi që kemi edhe

vende tjera. Sa i përket asfaltimit të rrugës Rubovc Lipjan në kemi bërë kërkesë në ministri për ndërtim të kësaj rruge, ndërtimin e rrugës Kojke Topliqan dhe 11 projekte tjera dhe ne ju kemi garantuar se do të participojmë dhe do të ju sigurojmë për punën nuk na kanë kthyer asgjë.

Egzona Bytyqi, tha se unë nuk diskutova për orarin e punës por për koeficientin e punëtorëve teknik të QKMF. Unë po them me të shikua procedurat si komunë pasi që disa komuna i kanë bërë këtë.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se ti po fol për shtimin e koeficientit të pagave që kanë hyr në punë me shkollë të mesme ajo shkon përmes proceduarve ligjore. Ne po ndodh në punë po hyje me shkollë të mesme tani po e përfundojnë fakultetin pastaj po kërkojnë që të ju rritet paga, ata vendin e punës e kanë me shkollë të mesme. Do ta shohim procedurat a kemi hapësirë ligjore ose jo.

Lulzim Rrustemi, tha se e kam një propozim të anëtarëve të kuvendit që me të përcjell pyetjet apo realizohen ose jo e jo me të përsërite pyetjet e njëjta thuaj se çdo muaj, pasi që edhe e kursejmë kohën dhe jemi me produktiv. Kam disa pyetje dhe kërkesa, e para është mirë që është rregulluar ura mbi lumin Sitnica një rrugë e rëndësishme për qytetaret, por ka mbetur pak keq një 50 metra dhe ka nevojë që të zhavorrohet. E dyta fshatrat Rufcat, Hallaqat, Ribari, Poturovci, ku në livadhe derdhet kanalizimi i Suhadollit dhe këtyre po ju shkakton probleme. Shkollat e mesme Adem Gllavica është kapluar nga zjarri a ka një raport zyrtar për dëmet e shkaktuara. Tjetra e kam një propozim në emër të grupit por besoj që pajtohen edhe grupet tjera që të bëhet rikonstruktimi i sallës pasi që nuk i plotëson kushtet dhe nuk ka komoditet.

Albiona Tasholli, tha se i kam disa kërkesa, e para ka të bëjë nga banorët e fshatrave Medvec, Magure, Vershevc, Llugaxhi, për asfaltimin e disa rrugicave, po ashtu edhe ndriçimi publik në Janjevë. Si dhe të bëhet rikonstruktimi i rrugëve "Afrim Zhitia" Isa Olluri "Sadik Shala" si dhe rruga Ribar i Madh Ribar i Vogël. Kam edhe një pyetje pse janë ndaluar punimet në rrugën Zllakuqan, Ribar. Pyetje për drejtorinë e Bujqësisë, a do të vazhdojë subvencionimi edhe për vitet në vijim për qumësht dhe a do të ketë edhe subvencione të tjera.

Rinor Murta, tha se kam kërkesë nga banorët e disa fshatrave për asfaltimin e parkingjeve afër shtëpive të të pamës.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha, sa i përket shtëpive të komuniteteve apo shtëpive të të pamës do të shohim koston pastaj me të buxhetuar këto, e drejtë si kërkesë. Rruga Zllakuqan Ribar është ndërprerë për shkak të përgjegjësisë së operatorit

është shkëput dhe do ta shohim me rishpall. Subvencionimi i fermerëve për qumësht është këtë vit dhe do te vazhdojmë ne vitet ne vijim. Edhe unë pajtona qe po përsëriten pyetjet ne kuvend dhe është mire te koordinoheni mes vete e jo te përsëriten pyetjet. Zhavorimi i rrugës, ne jemi ne procedure te kontraktimin dhe do ta shohim eshë atë rrugë. Ujërat e zeza ne regjionin e Rufcit, është ne territorin e komunës se Graçanices por ne duhet te bëjmë përpjekje me zgjidh atë problem. Ka ndodh një zjarr ne shkollën “Adem Gllavica”, por nuk kemi një raport detal. Sa i përket sallës së kuvendit, do të mundohemi ta ri dizajnojmë sallën . Shkolla “Adem Gllavica” është e buxhetuar qe 6 vite dhe aty është plus edhe 6 vite tjera dhe neve na ka bllokuar si komunë.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit, tha pasi që çështje të tjera nuk pati u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 26-të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 27 e Kuvendit , pas votimit konstatoi se Kuvendi me, 23 vota për aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja 27-të e Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II

Propozim vendim për miratimin e raportit te komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në komunën e Lipjanit për vitin 2023

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rexhep Rexhepit, drejtor i DBPZHR-së ,i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Raporti

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime të tjera nuk pati u kalua në pikën tjetër në vazhdim

Alban Salihu, tha ne dje në KPF e diskutuam këtë pikë dhe tham qe është mirë me na e dërguar edhe listën e fermerëve dhe na dërguat listën, por është mirë edhe herët tjera te na dërgohet lista sa herë që ka raste të tilla në mënyre që të kemi kohë me i analizuar.

Arsim Jashari, tha se ne e mbështesim këtë propozim, mirëpo emërtimi i propozimit është gabim duhet te rishikohet pasi qe po flasim vetëm për fermerët.

Albiona Tasholli, tha se ne grup i LDK-së e mbështesim këtë propozim vendim pasi që është në të mirën e qytetarëve.

Egzona Bytyqi, tha se ne edhe në KPF e kemi diskutuar këtë propozim vendim, është një vendim shumë i rëndësishëm. Kam një pyetje, a ka një afat ligjor kur do të ekzekutohen pagesat.

Rexhep Rexhepi, tha se ne ua kemi dërguar dje listat vetëm i kemi hequr të dhënat konfidenciale, emërtimi përfshin vetëm listën e vërshimeve dhe ne do ta përcjellim në Agjenci , nuk ka afat kohor se kur do të dalin pagesat.

Arsim Jashari, tha se unë thash shikoni vetëm emërtimin a e keni në rregull ose jo, edhe ne jemi anëtar të kuvendit dhe kemi dhënë betimin dhe mundemi edhe me dyer te mbyllura mi mbajt mbledhjet, emërtimi është i përgjithshëm duhet të ndryshohet.

Alban Salihu, tha se nëse shuma ka qenë e caktuar është dashtë me qen publike dhe kjo nuk cenon asgjë, ndërsa te dhënat konfidenciale as ne nuk kemi kërkuar.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se listat janë publike dhe mundeni me i marr kur te doni.

Rexhep Rexhepi, ne nuk e dimë a do ti paguajnë ose jo, krejt varet prej Agjensionit.

Arsim Jashari, tha se unë e kam problemin te emërtimi pasi që e keni të përgjithshëm a duhet te jetë i përvetshëm, pasi që këtu i keni 39 fermerë.

Diamant Bytyqi, tha se në vendimin e parë janë 178 fermerë dhe janë kanë tri kategori, ndërsa në këtë kane thënë vetëm prej listës se vërshimeve që janë 39 fermerë.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se ka dallim vendimi i sotit me atë të mbledhjes së kaluar.

Alban Salihu, tha se duhet që të na dërgohet lista me shumën e përfituesve.

Bashkim Budakova, tha se është një defekt në tabelë pasi që po i bjen sikur pula që e ka ngrënë qenin, është mirë që të korigjohet kjo pjesë para se të shkojë në ministri e keni te numri rendor 63 këtë gabim teknik.

Meqë diskutime të tjera nuk pati, Kryesuesi, vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi, se Kuvendi, me 28 vota për, aprovoi propozimin

III

Raport Financiar i KRM "PASTRIMI" SH.A për njësinë Operative te Lipjanit për vitin 2023

Lidhur me këtë pikë, kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Petrit Reqices, Kryeshef në ndërmarrjen Pastrimi i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se një raport pak i mangët, unë jam idhtar që me u nda kompania, në raport mungon reklamimi për vedisim. Nuk duhet të rritet çmimi se a po e shihni që po ka shpërngulje te madhe të qytetarëve, por duhet të jete një kampanje vedisuese për mos hedhjen e mbeturinave. Shpresojmë që komune do ta kemi kompaninë tonë pasi që ne si kuvend disa herë ju kemi ndihmuar.

Besiana Sylja, tha se një raport i mangët, ku mungon bilanci i gjendjes e shume çështje tjera. Me sa po shihet që ka zvogëlim te shpenzimeve këtë vit ne mënyre drastike me krahasuar me vitet paraprake, a ka pas keqpërdorim ne vitet paraprake apo pse? Kërkoj nga ana juaj që herët tjera te ketë një raport me detal e jo një raport kaq te mangët.

Rinor Murati, tha se sa i përket raportit e kam pa që këto ditë ka qarkulluar thirrja për përmbushje të obligimeve që klientët kanë ndaj kompanisë, në të kundërtën kalon në procedurë përmbarimore. Sa është borxhi i qytetarëve te komunës se Lipjanit ndaj kompanisë. Si dhe kur do të bëhet dislokimi i njësisë operative në Lipjan.

Fadil Spahiu, tha se i falënderoj për raportin por edhe për bilancin pozitiv, por kam një pyetje njësia operative ka vepruar me bilanc pozitiv, cilët kanë qen faktorët që ka pas bilanc pozitiv që të rritet cilësia dhe të njëjtën kohë të ulet kosto e shpenzimeve operative. Pyetja e dytë sa eshë vlere e investimeve në makineri dhe pajisje të tjera ,me krahasuar me vitet paraprake.

Shahadije Dragaçina, tha se te raporti i kam disa shqetësime, vërejtje të qytetarëve, vitin e kaluar kompania Pastrimi ka dërguar shumë qytetarë të

përmbaruesi pa paralajmërim që është në kundërshtim me ligjet përkatëse, për shkak se inkasantët sipas qytetarëve nuk ju kane dërguar faturat me kohë. A e keni bërë paralajmërimin me kohë, dhe a jeni në dijeni që nuk ju kanë shkuar faturat me rregull.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se një raport me bilanc pozitiv ,mirëpo te Lipjani po mungon tabela krahasuese, me nivelin paraprak. Unë i kam disa ankesa dhe shqetësime, nëse janë rritë inkasimet duhet të rriten edhe shërbimet. Tjetra në fshatra ka ankesa që mungojnë kontejnerët e bizneseve do te ishte mirë që të ju sigurohen kontejnerët bizneseve. Po ashtu mos pastrimi i kontejnerëve publik në fshatra.

Lulzim Rrustemi, tha se ju përgëzoj për raportin pozitiv. Ne si Lipjan jemi për decentralizimin e kompanisë, por unë e kam një pyetje se a po shkon drejt decentralizmit kompania pastrimi. Sa është e suksesshme njësi operative në Lipjan. Tash që do të barteni në lokacionin e ri a do ti merr shpenzimet kompania në nivel qendror dhe duhet të ketë edhe me shume kontejner te bizneseve. Pasi që kontejner për ekonomi familjare komuna ka shpërnda për te gjithë. Cila është rruga që njësi në Lipjan të decentralizohet.

Herolind Kozhani, tha se sa i përket mbathjeve te punëtoreve te kompanisë a do te ketë investime ne këtë aspekt.

Petrit Reqica, tha se ndarja e kompanisë do të jete versioni me i shpejt dhe më i lehtë. Ne gjendjen aktuale ka pas tentativa por ka qenë e pamundur, por ne prapë kemi vazhduar me idenë e decentralizmit. Kampanjë vedisuese kemi paraparë në planin e punës për 3 vitet e ardhëshme. Tarifa bëhet për njësi familjare. Në makineri kemi bërë investime dhe do të bëjmë ende. Raporti ka qenë i detajuar vetëm për Lipjan. Të hyrat janë ngritur, për shkak të rritjes të hyrave për shkak te inkasimit. Përmbarimin e kemi te vetmin mjet ligjor ku mund ti marrim mjetet tona. Unë ju falënderoj që i keni mbështet rastet me asistence sociale. Ne i kemi njoftuar edhe përmes mediave po ashtu edhe përmes faturave që ti bëjnë pagesat ose do te shkojnë te përmbaruesi. Faturat dërgohen përmes inkasantëve edhe aty inkasant kane një pjese të mjeteve për shkak te efikasitetit. Ne jemi duke e bere edhe rregulloren e re për sistemin e vendeve te punës po ashtu do ta kemi edhe digjitalizimin e thirrjeve. Te lokacioni i ri shpenzimet do ti bartim nëse mujm me mbuluar vetë. Te veshmbathjen e kemi shpall tenderin dhe do ti kane veshmbathjet me te mira ne rajon, punëtoret e kompanisë.

Arsim Jashari, tha a ka mundësi brenda rregullores që mos me lan me fut shumë në borxhe qytetarin, për shembull me lan 2 apo 3 muaj pa paguar po jo më

shumë. Po ashtu edhe rasteve me asistence sociale duhet me ju bo një zgjidhje dhe ju si nivel shtetëror duhet me gjet një zgjidhje.

Petrit Reqica, tha se shërbimet e mbeturinave nuk mundemi me i ndërpre sepse natyra e tyre është shume e ndjeshme dhe rrezikojmë shëndetin e përgjithshëm. Ne kur e dërgojmë te përmbaruesi e shënojmë që mjetet nga kjo kategori nuk mund të përmbarohen as të bllokohen që përfshihet këtu dhe rastet e socialit.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës, tha e falënderoj kryeshefin për gatishmërinë dhe bashkëpunimin që e kemi. Ne kemi pas takime zyrtare dhe ka vullnet të mirë që me i dhëne një orientim të ri menaxhimit të ndërmarrjes Pastrimi dhe mund të ndryshoj ambient në te gjitha komunat dhe do ta kenë mbështetjen time. Ne si komunë për veç lokacionit të ri për kompaninë pastrimi, e dyta do të vazhdojmë punën tonë me inspektorat për ata që hedhin mbeturina dhe ndaj atyre që nuk kanë shporta, sidomos institucionet dhe bizneset. Përmbarimi do të ishte mirë që të mos shkoj as shpejt të paken rastet sociale të mos shkojnë në përmbarim. Ne do ta marrim barrën kohë pas kohe për rastet e tilla.

Pastaj u dha pauzë deri ne ora 14: 15

Pas pauzës kryesuesi i kuvendit Daut Azemi, tha se vazhdojmë me pjesën e dytë te mbledhjes.

IV

Raporti i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën, Skender Bikliqi Kryesues i Komitetit për Komunitete, i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti?

Daut Azemi, kryesues i kuvendit, tha se e falënderoj kryesuesin e Komitetit për Komunitete për punën qe e keni bërë dhe bashkëpunimin qe keni pas ashtu edhe anëtarët e komitetit për punën qe keni bërë.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se e keni raportin para vetës, por dua ta shprehi indinjatën time për disa drejtor të cilëve edhe pse ju shkon ftesa për mbledhje te komitetit ata prapë nuk marrin pjesë në mbledhje. Kërkoj nga ana juaj që të ua tërhiqni

vërejtjen dhe të marrin pjesë këta drejtor në mbledhje. Po ashtu dua ta falënderoj nënkryetarin për komunitete për gatishmërinë që ta marr pjesë çdo here në mbledhjen e komitetit.

Shahadije Dragaçina, tha se e falënderoj kryesuesin e komitetit për raportin, në si anëtarë të këtij komiteti jemi munduar ta japim kontributin tonë për atë që kemi pas mundësi. Por shqetësuese mbetet jo serioziteti i disa drejtorëve të cilët nuk i kanë marrë seriozisht ftesat të cilat ju kanë dërguar për mbledhje, ku rastin e fundit e kemi në mbledhjen e fundit ku ka qenë e ftuar drejtoresha e DKRS-së, por nuk ka marr pjesë. Kërkoj një seriozitet më të madh ndaj këtij komuniteti.

Gentiana Hoxhaj, tha se e falënderoj kryesuesin e komitetit për raportin, po ashtu i falënderoj anëtarët e komitetit për bashkëpunimin që kemi pas.

Fadil Spahiu, tha se e falënderoj kryesuesin e komitetit për raportin e detajuar. Kam një pyetje për anëtarët e komitetit, gjatë takimeve me qytetarët e komunitetit jo shumicë përveç kërkesave dhe ankesave që i keni ngrit, a ka pas ndonjë ankese për diskriminim, apo neglizhencë nga stafet e institucioneve.

Alban Salihu, tha se edhe unë i falënderoj për raportin, po ashtu edhe anëtarët për punën që e kanë bërë dhe angazhimin e tyre, e sidomos vizitat në teren. Në të gjithë e dimë që gjendja e komuniteteve në Kosovë nuk është e mirë dhe ka hapësirë me punuar për të mirën e tyre. Unë e ftoj nënkryetarin për komunitete që të jetë sa më aktiv në socializmin e tyre, për punësim shkollim dhe çështje të tjera.

Rinor Murati, tha se e përgëzoi komitetin për punën dhe angazhimin e tyre. Braktisja e shkollimit nga komunitetet është shqetësim në të gjithë vendin jo vetëm në komunën tonë. Unë do të ndalem te vizita në Shkollën "Vëllëzrit Aksiq" në Rubovc të Madh, e kam par historien që është transmetuar nga ajo vizitë, por dua të dijë si ka rrjedhur vizita dhe a keni bërë paraprakisht njoftim për atë vizitë apo në mungesë të një njoftimi paraprak ka ndikuar në mos lejimin për të mos vizituar shkollën.

Arsim Jashari, tha se edhe unë i falënderoj për punën që po e bënë komiteti, por sa a po ka efekt puna juaj në praktikë pasi që ne e dimë që në nivelin e arsimit komunitetet janë me dobët, a po mund të bëni diçka për këtë dhe sa po realizohet kjo në praktikë. Ne kemi rastin të AMF në Bnaujë është një familje dhe nuk e di ku janë duke shkuar në shkollë ata fëmijë. DKA-ja, duhet mu marr me këtë temë ku po zhvillojnë mësimin ata fëmijë.

Skender Bikliqi, tha se ne i bëjmë rendin e ditës në bazë të planit të punës, po ashtu kemi bashkëpunim shumë të mirë si komitet dhe çdo herë rekomandojmë kuvendit dhe ekzekutivit për problemet që i shohim te komunitetet. Po ashtu edhe ftesat ua dërgojmë me kohë të gjithë drejtorëve është çështje e tyre nëse ata dojnë me marr pjesë ose jo.

Imri Ahmeti kryetar i komunës tha se, e falënderoj kryesuesin e komitetit për raportin po ashtu edhe anëtarët e komitetit për punën e tyre. Ne vazhdojmë të punojmë për të mirën e të gjitha komuniteteve. Lulzim Qerimi është nënkryetar i komunës për komunitete dhe përfaqëson ekzekutivin e komunës. Nuk ka askund rrugë as rrugicë të pa asfaltuar ku banojnë komunitetet e që nuk kemi intervenuar po ashtu edhe për ndriçim publik kanalizim dhe çështje të tjera. Më mirë se në Lipjan nuk janë askund komunitetet dhe këtë e kanë vlersuar organizata vendore dhe ndërkombëtare. Ne i kemi 4 shkolla ku bëhet mësim shtesë për komunitetet. Dhe ne kemi edhe shumë punë të mirë për këto komunitete, pasi që ku kemi qenë jemi mirë dhe nuk duhet me u nënçmuar puna e cila është bërë në teren. Ligjet nuk lejojnë ndërhyrje në punësim. Ky komitet do ta ketë mbështetjen time, për të vazhduar punën me intensitet. Rasti që u përmend më herët nuk është banorë i komunës sonë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se unë e falënderova nënkryetarin se e di që nuk e ka obligim ligjor, por ne e vlerësojmë prezencën e nënkryetarit në çdo mbledhje dhe nuk e di kujt ju referua kryetari, se kur po vjen nënkryetari edhe ne si komitet po e kemi më lehtë sepse po sqarohen disa gjera. Drejtorët që marrin ftesën e kanë obligim me marr pjesë në mbledhje të komitetit. Sa i përket vizitës në Rubovc që u pat bërë, publike, mendoj që është bërë një gabim i sektorit të kuvendit e është dashtë paraprakisht me njoftu drejtorin e shkollës për një takim të komitetit ndërsa ata fare nuk kane qenë të njoftuar. E dyta, është caktuar një javë më herët para zhvillimeve në veri, dhe ata fare nuk kanë pranuar.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit, tha sa për sqarim, obligimi i kryesuesit të komitetit është që me njoftuar paraprakisht institucionin ku do të bëhet vizita.

Alban Salihu, askush nga ne nuk kemi kritik, kërkesa për me përmirësuar gjendjen e komuniteteve është legjitime, dhe unë nuk mendoj që gjendja e komuniteteve është e mirë në Lipjan, ashtu siç po e thoni ju? Ne tash jemi në një situatë që shumë kompani po kërkojnë punëtorë dhe gjendja e komuniteteve nuk është e mirë dhe sikur të punësoheshin këta do të ishte mirë.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se ju i ndërruat fjalët, sepse the me ndërhy në procesin e punësimit. Tjetra nuk mund të konstatohet gjendja e komuniteteve jashtë raportit zyrtar të qeverise, Lipjani është më së miri në këtë stad. Kur të flisni diçka bazohu në fakte.

Lulzim Qerimi, tha se sa i përket gjendjes se komuniteteve në Lipjan është e mirë falë të gjithëve, por ne si komitet kemi edhe sfida, porë si në Lipjan askund nuk ka bashkëjetesë. Po ashtu i falënderoj te gjitha institucionet arsimin, shëndetësisë për trajtimin që ua bëjnë komuniteteve. Si sfidë e kemi arsimin edhe punësimin. Por sa i përket punësimit sot kanë ardh kushtet po nuk po dojnë me aplikuar. Unë pres edhe më shumë që të përmirësohet gjendja e komunitetit. Dhe unë çdo herë jam i gatshëm që të ndihmoj për të mirën e komuniteteve.

Alban Salihu, tha se unë jam i mendimit që gjendja e komuniteteve në Kosovë por edhe në Lipjan nuk është e mirë dhe ka hapësirë për tu përmirësuar dhe nuk thash që nuk është bërë asgjë. Sa e kena të përfshirë gjendjen e komuniteteve të përfshimë në Arsim, nëse ajo është gjendje e kënaqeshme atëherë edhe unë po pajtohna me ty.

Lulzim Qerimi, tha se unë e thash që problemet që janë të komunitetit nuk mundemi me i zgjidh asnjëri pasi që niveli i shkollimit të ulet nuk ka nevojë për bursa dhe nëse e kanë gjendjen ekonomike të keqe le të lajmërohen te unë dhe unë do të ju ndihmoj, pasi që e kam përkrahjen e kryetarit ka qen kryetari më miqësor në Kosovë.

Shadije Dragaçina, tha se ne mbledhjen e fundit të komitetit njeri nga anëtarët e komitetit serb që ai e përfaqëson thotë pse me aplikuar në për subvencione kur dihet mire si shkon, d.m.th. edhe komuniteti serb e kane kuptuar si shkojnë subvencionet.

Daut Azemi, kryesues i kuvendnit tha se është një rregullore për subvencione dhe aty i keni kriteret se kush mund të jetë përfitues i subvencionit. Ekzekutivi ju ka dhënë përparësi komuniteteve aq sa kanë aplikuar.

Arsim Jashari, tha se pajtohna që komuna e Lipjanit e ka kulturën e tolerancës, por me sa u tha më lartë problemi qëndron te arsimi, por ne duhet të gjithë se bashku me ndiku te komunitetet që ato me u shkolluar, që me u ngrit niveli me qenë të barabartë.

Imri Ahmeti, tha se, gjendja e komuniteteve është e mirë, pasi që komuna është kujdes duke berë dhe mësim shtesë, po ashtu dhe duke i subvencionuar në mënyra te ndryshme. Ka baza ligjore në cilat punojmë, Këshilli i Evropës e ka shpall Lipjanin si komunën më miqësore për komunitete.

Pastaj u kalua në pikën në vazhdim

V

Raporti i përformancës së komunës së Lipjanit për vitin 2022

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Shemsi Azemit, koordinator i përformancës i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, pse raporti i vitit 2022 vjen në vitin 2024, e dyta ka pyetje që nuk kuptohen ose dalin të pa kuptimta. Në vitin 2022 nuk janë transmetuar live mbledhjet e kuvendit e ju e keni vlerësuar me 100% po ashtu edhe diskutimet publike 100%. Po ashtu pjesëmarrja e kryetarit në dëgjime publike 100%.nuk po shoh vlerësim real. Te hapësirat publike ka ulje pse ka ulje në këtë fushe. Te transporti publik a ju keni referuar transportit privat me siguri se në Lipjan nuk ka transport publik. Dhe te parkingjet publike vetëm 9 parkingje janë të rezervuara për personat me nevoja të veçanta, pasi që po bëhet parkingu nëntokësor tëbëhen ma shumë parkingje për personat me nevoja të veçanta.

Besiana Syla tha sa i përket raportit të përformancës , komuna e Lipjanit edhe pse ëshë në pozitën e parë në nivel vendi e ka humbur grantin sepse nuk e ka përmbushur kriterin e shpenzimit të buxhetit në veçanti te investimet kapitale. Ne raportin e perfomaces ka edhe pozicione të ngrira, pse janë të ngrira këto pozicione. Pse figuron zero te hapësirat publike. Pse nuk është punuar ende në planin komunal për transport lokal publik. Po ashtu ka ngecje në trajtimin e ujërave të zeza. Regjistrimi në emër të dy gjinive i vogël, hapësira e metrit katror për nxënës një hapësirë shumë e vogël. Ky raport na jep një sinjal se ku duhet komuna me i përqendrua investimet dhe me investuar.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se raporti i performances matet ne 3 fusha, atë në: qeverisje demokratike ,nga menaxhimi i komunes edhe nga shërbimet. Te gjitha këto pastaj ndahen në 9 fusha në 29 indikator në 119 tregues dhe gjithçka duhet me u dokumentuar. Është mirë me u gëzuar edhe kur ka suksese, pasi qe këtu është duke u berë një punë e mirë në institucione. Lipjani për vitin e 10 e merr raportin e auditorit për performancën më të mirë dhe jo vetëm të auditorit por edhe të shume organizatave vendore dhe ndërkombëtarë. Ka fusha të ngrira pasi që menaxhohen

nga niveli qendror. Pse e vitit 2022 në vitin 2024, kjo është çështje e ministrisë. Jemi më mirë se shumë komuna që janë në fundë të tabelës, por ka nevojë edhe për punë më te mira. Unë i përgëzoj zyrtarët e shërbimit civil pe punën e tyre. Ne raport janë disa pyetje që jo gjithkush mund ti njoh.

Shahadije Daragaçina, tha se në raport të transparencës figuron që 100% janë transmetuar live mbledhjet e kuvendit kur dihet që nuk ka ndodh një gjë e tillë pasi që ne e kemi diskutuar disa herë. Te përgjegjshmëria e kryetarëve të këshillave thuhet se kanë mbajtur 6 takime, unë e di që kjo nuk është e sakte sepse ata nuk kanë mbajtur takime. Në raport ka ramje të hapësirat publike dhe të infrastruktura rrugore dhe ju e keni quajtur rrënjë të lehtë. Në raport po ashtu ka ulje edhe të fusha e kanalizimit me krahasuar me atë që thuhet nga kryetari.

Imri Ahmeti, unë e kam thënë dhe e them prapë që jemi shumë mirë me kanalizim, pasi që ne kemi në statut fshatra që janë në statut dhe nuk kanë asnjë shtëpi siç janë Vogoqica, Shisharka, Bukovica dhe fshatra të tjera dhe ajo na ul përqindjen e kanalizimit në performancë. Duhet me njoft sistemin jo me fole kot, Lipjani është shumë mirë 95% është i përfunduar

Me që diskutime të tjera nuk pati u kalua në piken në vazhdim.

VI

Raporti, Janar-Dhjetor 2023, i punës së zyrës së Kryetarit dhe drejtorateve komunale

Lidhur me këtë pikë, kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Ahmetit, kryetar i komunës së Lipjanit i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se sa i përket raportit, e falënderoj publikisht avokatin e komunës që e ka dhënë një raport të detajuar me krahasuar me avokaten më herët. Te derivatet e kuptoj shpenzimet të kryetari, mirëpo e kam thënë disa herë e them prapë nuk e di pse duhet të gjithë drejtoret me shkua pas kryetarit për një përrurim apo për një rrugë. E dyta të konkurset publike të anuluar nga sektori i personelit për shkaqe teknike. E dyta konkurset dalin vetëm në gjuhen shqipe. Te paditë për prona private është shqetësuese. Te lëndët e arsimit ka shumë mjete dhe po ka shpenzime është mirë të bëhet një zgjidhje pasi që po dëmtohem. Te përgjegjshmëria në punë, një pjesë e

drejtorëve dhe zyrtarëve i sheh nëpër kafe brenda orarit të punës dhe kjo nuk është në rregull.

Shahadije Bikliqi, tha se në raport ka gabime teknike dhe jo seriozitet. Nëse e shohim Sektorin për përfaqësim dhe çështje ligjore ne jemi dëshmitar që ky sektor në shumë raste ka vepruar pa e konsultuar ligjin ku shumë propozim vendime e propozim rregullore të cilat janë votuar në kuvend, janë kthyer të jashtëligjshme nga niveli qendror. Në fushën e Arsimit kemi shumë dështime, siç është rasti i nxënësve të shkollës “Vëllezërit Frashri” që janë shkuar në shkollën “Adem Gllavica.”Ka po ashtu dështime siç ka qenë rasti me sallën e sportit në Lipjan, po ashtu edhe ndërtimi i projektit të sheshit dhe nënkalimit. Në raport shihet që ka pa përgjegjshmëri dhe keq menaxhim.

Fitim Mëziu, tha se sa i përket raportit të ekzekutivit një raport voluminoz, unë do të diskutoj disa elemente të shëndetësisë të cilat janë brengosëse, siç është ikja e mjekëve është nga Lipjani. Një numër tjetër nuk donë të shkojnë në mjekësi familjare. Tjetra numri i të sëmuarve nga tuberkulozi kemi rritje me krahasuar me vitin paraprak. Kemi afër gjysmë milioni shërbime shëndetësore ku shumica nga këto janë në emergjencë. Diçka që do ta ngris stafi shëndetësor që po pensionohet duhet të përshëndet në mënyrën më të mirë e jo vetëm me një certifikatë pasi që kanë bërë punë të mirë për vendin.

Besiana Sylja, tha se raporti i ekzekutivit, thuhet që komuna e Lipjanit ka përfituar grant të performances ky nuk ka të bëjë me vitin 2023, por me vitin 2021, ku dihet që komuna nuk ka arrit me fitua garantin për shkak mos shpenzimit të buxhetit. Te njësia e auditimit të brendshëm nuk ceken rekomandimet, dhe me sa shihen me shumë këtu kemi një raport statistikor se sa përmbajtjesor.

Ardit Cani, tha se një raport voluminoz, por do të ndalem te drejtori i kulturës, te subvencionimi i klubeve sportive ka pas ankesa me mënyrën e ndarjes së mjeteve.

Lulzim Rrustemi, tha se një raport i rëndësishëm. Janë do komisione të kuvendit dhe komitetet ku është dashtë me dal me rekomandime për raport me dite që edhe na po punojmë diçka. Unë i kam disa vërejtje sugjerime dhe rekomandime. Do të ndalem në disa drejtori, te Buxheti, kemi shumë mjete suficit ku kemi shumë projekte që nuk janë realizuar fare, apo kanë dështuar dhe mjete kanë humbur për shkak të tyre. Nuk e kemi në projekt rrugën Kojске- Topliaqan, mungon një shkolle në Lipjan, po ashtu keq i kemi punët me ujë të pijes në disa vende siç është regjioni i Kraishtes, po ashtu trajtimi i ujërave të zeza është keq. Shpenzimi i buxhetit te

projektet e mëdha, por punimet janë ende në fillim dhe një shumëë e madhe. Jam i pakënaqur me asfaltimin e rrugicave private pasi që ata pe padisin Komunë edhe pse po ju shtrohen rrugët e ato mjete do të ishte mirë me shkua në Arsim dhe Shëndetësi. Te DKA-ja, mungojnë edhe institucionin parashkollorë në raport po ashtu dhe shkollat e minoriteve. Dhe këtu kemi një raport te mangët te DKA-ja, pasi që është dashtë të specifikohen të gjitha. Te nxënësit keni gabime te mungesat e nxënësve për vitin 2022/23 për gjysmë vjetorin e parë. Te niveli 1 deri 5, dhe këtu ka gabime teknike. Po ashtu llogaritja e mungesës së nxënësve në shkolla ka gabime. Po ashtu edhe nxënësit e pa notuar ka gabime, si dhe te orët e pa mbajtura, në shkolla. Në Lipjan ka nevojë shumë për punë në arsim. Te shëndetësia është gjendja më mirë. Por kemi humbje te një granti qeveritar te shëndetësia, te DKRS-ja, ka pas disa parregullsi te ndarja e subvencioneve.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se e thash që ka progres në disa fusha por nuk kemi arrite idealen. Çështjet teknike mund të ketë por mund te përmirësohen. Pagesat e projekteve kapitale janë publike te ne dhe te thesari dhe mund ti shihni, Shumë e mjeteve ka te beje me shpronësimin. Mjetet e performances te vitit 2022 mund te shfrytëzohen tash. Disa kontrata janë ndërpre për shkak të mos përmbushjes së kriterëve. Salla e sporteve ka garancinë dhe aty kanë qenë dy menaxher një i Ministrisë se Kulturës tjetri i komunës. Shumë shpejt do ta keni edhe një projekt për ballë sallës sportive. Pronat private të cilat janë asfaltuar e kemi marr pëlqimin e pronarëve, por kushdo që na ka paditë pse ja kemi shtuar asfaltin ne do të ja heqim asfaltin. Impianti i ujrave të zeza një prej padrejtësive me të mëdha që ju ka berë Lipjanit. Po ashtu kemi probleme dhe me rrjetin e kanalizimit te QMI-ja. Përditshmëria në punë, kushdo që i sheh drejtorët apo zyrtarët në orar te punës fotografoni dhe mi dërgoni, shërbyesit civilë janë në gjendje jo të mire, dhe shihen me një sy të keq dhe akuzohen shpesh here. Jemi keq me shërbyesit civilë pasi që kemi shumë zyrtar civilë qe rrijnë jashtë orarit në pune dhe nuk mund ti paguajmë. Veturat zyrtarisht i kameë unë, nënkryetari dhe kryesuesi. Nuk të vjen ty kurrkush me te punua në komunë për këtë pagë

Meqë diskutime të tjera nuk pati u kalua në pikën në vazhdim.

VII

Propozim Vendim për miratimin e planit për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Lipjanit 2024-202

Lidhur me këtë pikë, kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Burim Rrustemit, nga DSHPMM, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Shahadije Bikliqi, ky raport ka ardh me vonese unë nuk do ta përkrahi dhe nuk do të marr pjesë ne votim.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit, tha ka qenë edhe në seancat më herët dhe vetëm disa ndryshime i ka pas.

Egzona Bytyqi, tha se ky plan është i një rëndësie te veçantë, ne si grup e përkrahim.

Meqë diskutime të tjera nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit, dhe pas votimit, konstatoi se, Kuvendi, me 20 vota për, aprovoi propozimin

Pasi që çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 16:55.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi